



Qendra për Arsim e Kosovës
Kosova Education Center

KEC

Kodi: 062

Programimi kompjuterik (Klasat 1-9)

Tipi i programit: Plotësues

Hyrje:

Programi i Arsimit Themelor (BEP) është program pesëvjeçar i cili financohet nga Agjencia për Zhvillim Ndërkombëtar e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (USAID) dhe nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), dhe implementohet nga FHI 360, me qëllim të ofrimit të përkrahjes për shkollat kosovare që të zhvillojnë shkathtësitë relevante të shekullit 21 të nxënësit.

Programi i Arsimit Themelor përbëhet prej tri komponentëve kryesorë:

1. Zhvillimi i kapacitetit të komunave dhe shkollave për udhëheqjen dhe menaxhimin e shkollave
2. Zhvillimin e kapaciteteve të shkollave për vlerësimin për të nxënë dhe
3. Përmirësimin e zhvillimit të mësimdhënësve pa shpërblyer nga puna.

Komponenti i tretë për zhvillimin e mësimdhënësve implementohet në partneritet me Qendrën për Arsim të Kosovës (KEC), e cila i koordinon aktivitetet në këtë komponentë me një qasje të integruar dhe në bashkëpunim të ngushtë me personelin teknik të Programit për Arsim Themelor.

Programi për Arsimin Themelor gjatë periudhës 2011/2014 ka zhvilluar një program koherent për zhvillimin profesional të mësimdhënësve pa shpërblyer nga puna. Ky program dallon nga trajnimet e deritanishme për disa arsye. Së pari, për arsye se pjesa më e madhe e këtij programi zhvillohet me bazë në shkollë, dhe ndërmerr një sërë masash për sigurimin e cilësisë dhe qëndrueshmërisë:

1. Janë hartuar dhe miratuar Standardet e BEP për Fasilitimin e të Nxënës;
2. Është hartuar dhe miratuar Lista e Shkathtësive Prioritare e BEP;
3. Janë akredituar nëntë kurse për zhvillimin profesional të mësimdhënësve, si dhe janë hartuar, testuar dhe përgatitur për akreditim edhe dy kurse tjera të kësaj komponente;
4. Janë zhvilluar kapacitetet për implementimin e këtyre kurseve (deri tani janë 48 kryefasilitatorë dhe 472 fasilitatorë shkollorë);
5. Janë themeluar dhe pajisur Qendrat për Zhvillim Profesional (QZhP);
6. Janë shpërndarë paket me pajisje teknologjike nëpër QZhP dhe shkolla për të mundësuar implementimin e këtyre kurseve.

7. Janë hartuar doracakët për kurset përkatëse për të ndihmuar informimin për qasjet e reja në mësimdhënie dhe të nxënë në shkollat kosovare.

Kurset për zhvillimin profesional të mësimdhënësve janë hartuar nga KEC-i në kuadër të jetësimit të këtij programi të BEP për zhvillimin profesional të mësimdhënësve kosovarë dhe janë në përputhje të plotë edhe me prioritetet dhe me objektivat strategjike të Planit Strategjik të Sektorit të Arsimit të MASHT (2011-2016) për përmirësimin e mësimdhënies dhe të nxënës në Kosovë. Qendra për Arsim e Kosovës është e përkushtuar ndaj ngritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënës përmes zhvillimit profesional të mësimdhënësve pa shpëputje nga puna. Deri tani, KEC ka zhvilluar dhe implementuar dhjetëra programe për aftësimin e mësimdhënësve vet dhe në bashkëpunim me partnerë vendorë dhe ndërkombëtarë, përfshirë MASHT-in dhe drejtoritë komunale të arsimit.

“Programimi kompjuterik” është zhvilluar në kuadër të përpjekjeve të Programit për Arsimin Themelor për të ndihmuar arsimin kosovar në zhvillimin e shkathtësive relevante të shekullit XXI tek nxënësit e shkollave fillore. Kursi është hartuar nga një grup punues i udhëhequr nga konsulentja vendore Burbuqe Hana me kontributin e mësimdhënësve Berat Bejtullahu, Zana Kurtishi Rudi, Sabri Rudari dhe Dafina Lama. Procesi është zhvilluar nën koordinimin e koordinatorit për teknologji arsimore, Arsim Ilazi. Krijimin e këtij kursi e ndihmoi edhe kompania ORACLE e cila i trajnoi dy fasilitatore në modulën ALICE dhe i siguroi materialet e këtij moduli.

Para se të ofrohet për akreditim, kursi është testuar me sukses me një grup prej 33 mësimdhënësish/bashkëpunëtorësh të Programit, të cilët kanë pasur rast të japin sugjerimet/rekomandimet për përmirësimin e aspekteve të caktuara të kursit.

Përshkrimi i kursit: Kursi “Programimi kompjuterik” është konceptuar për t’u ofruar në Qendrat për Zhvillim Profesional, për të gjithë mësimdhënësit e nivelit (1-9), në veçanti ata të cilët janë të interesuar në Programim të kompjuterit. Programi realizohet në formë të kursit treditësh. Kursi organizohet në dy vikende radhazi. Pas përfundimit të kursit mësimdhënësit realizojnë aktivitetet praktike në shkollë me nxënësit dhe mbajnë seanca reflektimi me fasilitatorët. Njëkohësisht ata prezantojnë dosjet e zhvillimit profesional të tyre, dhe fasilitatorët e kolegët japin informata kthyesë. Kjo dosje kontrollohet nga fasilitatorët dhe drejtori i shkollës, nga të cilët dalin rekomandimet për përmbushjen e kriterëve për certifikim. Pas përfundimit të kursit, pjesëmarrësit vazhdojnë t’i zbatojnë teknikat e kursit në mësimdhënien e tyre dhe vazhdojnë ta mirëmbajnë/plotësojnë tutje dosjen e zhvillimit profesional të mësimdhënësve.

Kursi është zhvilluar me qëllim që të ketë një ndikim tek nxënësit që përfundojnë shkollën fillore dhe të mesme të ulët dhe zhvillimin e njohurive dhe aftësive të duhura në bazat e programimit kompjuterik.

Qëllimi i kursit: Qëllimi i punëtorisë trajnuese është që pjesëmarrësit/et të njoftohen me procedurat dhe format e programimit si dhe programimin përmes argëtimit. Në të njëjtën kohë përmes shfrytëzimit të mirëfilltë të teknologjisë informatike synohet të përmirësohet cilësia në arsim.

Rezultatet e të nxënit:

Pas përfundimit të kursit, vijuesit do të jenë në gjendje të:

- Aplikojnë programet kompjuterike të kursit në zhvillimin e njësive mësimore të lëndëve të ndryshme.
- Programojnë me ndihmën e programeve kompjuterike të punuara gjatë kursit

Implementimi i kursit (metoda, forma, dhe vendi):

Kursi "Programimi kompjuterik" do të realizohet në dy format e paraqitura në vijim:

- 1. Kursi treditësh (18 orë):** Në formë të punëtorive të fasilituara nga 2 fasilitatorë të aftësuar dhe të certifikuar nga Programi për Arsimin Themelor (BEP) i USAID-it, komponenti i zhvillimit profesional të mësimitdhënësve, i implementuar nga KEC. Secila nga tri ditët e kursit ka nga katër sesione pune 90 minutëshe.
- 2. Zbatimi i teknikave të kursit në procesin mësimor në shkollë – zhvillimi i dosjes profesionale (6 orë):** Mësimitdhënësit realizojnë njësi mësimore duke përdorur programimin kompjuterik të përvetësuar gjatë kursit dhe i zbatojnë ato në klasat e tyre. Këto njësi mësimore mund të përgatiten me njërin apo të tre modulet e kursit, varësisht nga lënda e mësimitdhënies. Ata njëkohësisht, zhvillojnë dosjen e tyre profesionale e cila përmban njësitë e planifikuara mësimore, fotografi/video, punime të nxënësve, reflektime personale, informata kthyesë nga kolegët/et, etj.
- 3. Mbështetja e mësimitdhënësve nga fasilitatorët shkollor / kolegët:** Për të mbështetur mësimitdhënësit gjatë punës së tyre në shkollë, Programi inkurajon mësimitdhënësit që të shfrytëzojnë ekspertizën e fasilitatorëve shkollorë për të kërkuar ndihmë në formë këshillimi apo forma tjera që të realizojnë qëllimet e zhvillimit të shkathtësive programuese tek nxënësit. Poashtu, inkurajohen takimet e shkurtra/seancat reflektuese të shkëmbimit të përvojave mes kolegëve. Të gjitha reflektimet lidhur me këshillat, dhe takimet eventuale reflektuese, mësimitdhënësi i grumbullon si dëshmi në dosjen e zhvillimit profesional të tij.

Informata mbi planifikimin e mëtutjeshëm: Numri i synuar i mësimitdhënësve të trajnuar për vitin shkollor 2013/14 është 50.

Vlera e aktiviteteve të kursit e shprehur në orë për licencim: Ky kurs ka gjithsej 24 orë kredi

Certifikimi: Kushtet për certifikimin janë të përshkruara më poshtë

1. Pjesëmarrja me rregull në kurs e së paku 90% të kohëzgjatjes së kursit;
2. Realizimi i së paku pesë (5) njësive mësimore sipas teknikave të kursit, i dokumentuar përmes dosjes së zhvillimit profesional;
3. Shikimi i dosjes së zhvillimit profesional nga drejtori dhe rekomandimi i tij / saj për përmbushjen e kriterëve për certifikim.